



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Njoftim për media

Ditën e mërkurë, më datë 17.12.2014, u zhvillua mbledhja e radhës e Këshillit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në prani të anëtarëve të mëposhtëm:

Z. Gentian Sala Kryetar

Z. Gledis Gjipali Anëtar

Z. Piro Misha Anëtar

Z. Zylyftar Bregu Anëtar

Pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës u miratuan vendimet si më poshtë:

1. “Për miratimin e projektbuxhetit të vitit 2015”;
2. “Për një ndryshim në projektstrukturën, organikën dhe numrin e punonjësve të administratës së Autoritetit të Mediave Audiovizive”;
3. “Për miratimin e modelit të vulës për bllokimin e pajisjeve transmetuese dhe/ose ndalimin e funksionimit të tyre”;
4. “Mbi ndryshimet në të dhënat e paraqitura në kërkesën për autorizim nga shoqëria “Erzeni Kabëll Tv” sh.p.k., autorizuar për ripërsëritjen e programeve audiovizive të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Erzeni”.

Përveç sa më sipër, u morën në shqyrtim ankimet administrative të subjekteve audio dhe/audiovizive të ndëshkuara me sanksione gjobë dhe në përfundim u vendos:

1. Shfuqizimi i gjobës së vendosur ndaj subjektit kabllor “Lapardha”;
2. Lënia në fuqi e gjobës së vendosur ndaj subjektit kabllor “Fraholli”;
3. Shfuqizimi i gjobës së vendosur ndaj subjektit kabllor “TVM Devolli”.
4. Shfuqizimi i gjobës së vendosur ndaj subjektit kabllor “Fier- Shegan”.
5. Shfuqizimi i gjobës së vendosur ndaj subjektit kabllor “Irla”.
6. Shfuqizimi i gjobës së vendosur ndaj subjektit kabllor “Ani”.
7. Lënia në fuqi e gjobës së vendosur ndaj subjektit kabllor “Cable Albania Elbasan North”.

Këshilli ra dakord të rishikojë vendosjen e sanksioneve me gjobë për subjektet kabllorë “Iliria” dhe “Përrenjas” pasi të kenë shlyer detyrimet financiare brenda datës 05.01.2014.

Tiranë, më 17 Dhjetor 2015



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE